

**PLAN VEPRIMI I SHKURTUAR
PËR SHPRONËSIM**

RRETHRROTULLIMI KORÇE

Results Based Road maintenance and Safety Project (RRMSP)

Loan No: 8489-AL

Reference / Project No: P132982

NJESIA E ZBATIMIT – AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR (ARRSH)

Konsulent: Erjona Bajraktari

Shkurtime

BB	Banka Botërore
NjZP	Njësia e Zbatimit të Projektit
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
PNP	Personat e Ndikuar nga Projekti
RAP	Plani Veprimit për Rivendosjen
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
VKM	Vendimi I Këshillit të Ministrave

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	2
Titujt:.....	8
Kriteret ligjore për vlerësimin e pronësisë.....	11
Kriteret e Bankës Botërore për vlerësimin e pronësisë	13
Përgjegjësitë Institucionale për zbatimin dhe mekanizmi i ankesave	15
Përgjegjësitë Institucionale për zbatimin e Projektit.....	15
Mekanizmi i ankesave.....	16
Tabele - 4 Afati kohor dhe buxheti	17

Përmbledhja ekzekutive

Qëllimi primar i projektit është të zhvillojë dhe zbatojë planifikimin me kosto efektive që mbështet operimin e sigurt të rrugës dhe siguron mirëmbajtjen në nivelet e kërkuara të shërbimit. Mirëmbajtja e rrugëve është rezultat i një sërë operacionesh dhe aktiviteteve që synojnë ruajtjen e karakteristikave strukture dhe funksionale të rrjetit rrugor. Në këtë Projekt, do të përdoren katër kontrata të PBC, mesatarisht 350 km secila, duke mbuluar rreth 1,033 km rrugë nacionale primare (P) dhe primare-sekondare (PS). Kontratat PBC do të përfshijnë:

- Mirëmbajtje periodike, e cila sipas projektit, do të përfshijë përmirësime dhe rehabilitimin për të rivendosur integritetin strukturor dhe cilësinë e udhëtimit me automjet në pjesët e dëmtuara rëndë të rrugëve, kryesisht përmes riparimit intensiv të trotuareve dhe punimeve ndihmëse. Përmirësimet gjithashtu do të trajtojnë kushtet e pasigurta të rrugëve.
- Mirëmbajtje rutinë, që synon ruajtjen e aseteve rrugore deri në nivelin e përcaktuar të shërbimit (NSh). NSh do të lidhet me aspekte të tilla cilësia e udhëtimit, komoditetin dhe sigurinë, dhe do të përfshijë gjithashtu mirëmbajtjen gjatë dimrit.
- Punë emergjente - për të rivendosur rrugët në funksion pas dëmtimit të ndodhur si rezultat i fenomeneve natyrore ose aksidenteve.

Gjatë zbatimit të projektit, do të ketë nevojë për blerje të tokës në nivele të vogla (ndoshta pa nevojë për rivendosjen e njerëzve) për disa nga Punët e Përmirësimit në kuadër të RRMS (kryqëzimet e mëdha që do të konvertohen në rrethrotullime etj.), kufizimin ose humbjen e aksesit në asetet dhe burimet ekonomike, duke çuar përfundimisht blerjen dhe kompensimin e tokës. Aktualisht, ka katër raste specifike: Rrethrotullimi i Korçës, Rrethrotullimi i Laknasit, Kryqëzimi Qafe-Thanë dhe By-pass i Pocemit.

Ky dokument është një Plan Veprimi i Shkurtuar për Shpronësim - RAP dhe është i përgatitur për të adresuar shpronësimin e tokës për rastin e rrethrotullimit të Korçës. Plan i Veprimit për Shpronësim është përgatitur i *shkurtuar* për shkak të ndikimit të ulët për 15 familjet.

Planet për fazën e parë kanë konsideruar nevojën për të minimizuar ose për të shmangur marrjen e tokës. Për të arritur këtë, zgjerimi i rrethrotullimit është projektuar të jetë sa më afër rrethrotullimit ekzistues. Asnjë strukturë nuk do të ndikohet për investimet e mbuluara me këtë RAP të shkurtuar.

Metoda e propozuar e kompensimit për këtë procedurë të shpronësimit është në të holla e cila është e pranueshme në bazë të konsultimit me personat e prekur. Çmimet e referencës do të vendosen pas analizës së legjislacionit si dhe analizës së çmimeve të tregut në Korçë. Të gjithë Personat e prekur nga projekti - PNP kanë pranuar kompensimin në para *cash* si metodë për kompensimin e tokës së tyre të shpronësuar për interes publik.

Metodologjia e përdorur në përgatitjen e RAP të shkurtuar bazohet në kërkesat e politikës operacionale të Bankës Botërore për zhvendosjen e pavullnetshme (OP4.12) dhe Kornizën e Politikave të Zhvendosjes. Këto parime konsiderohen në përputhje me ligjet dhe aktet e Qeverisë Shqiptare.

Përshkrimi i Projektit dhe ndikimet

Segmenti rrugor që i përket projektit kalon nëpër një territor të sheshtë në fushat bujqësore të rajonit të Korçës. Rrethrotullimi i ri është i pozicionuar në fillim të rrugës kryesore drejt qytetit të Korçës. Rrjedha e trafikut në këtë udhëkryq është relativisht e lartë. Rruga lidh rrjedhën e trafikut që vjen nga Pogradeci dhe Kapshtica. Kryqëzimi ekzistues ka një shikueshmëri të ulët, për shkak të zgjidhjes ekzistuese me ishuj të centralizuar dhe ishuj të veçuar, të cilat nuk janë të pajisura me korsi përkatëse të përshpejtimit dhe ngadalësimit.

Raporti teknik tregon se bordurat ekzistuese të ishujve janë dëmtuar dhe jo të dukshme për të gjithë drejtuesit e automjeteve që kalojnë nëpër këtë kryqëzim. Disa nga sinjalet vertikale të trafikut janë të dëmtuara. Kullimi sipërfaqësor nuk është i përshtatshëm, kështu që sistemi ekzistues i kullimit ka nevojë për rehabilitim dhe mirëmbajtje. Ekziston mungesa e shenjave rrugore dhe vertikale / horizontale. Ky është një kalim shumë problematik i segmentit rrugor (SH3).

Gjatë hartimit të projektit për fazën e parë, u vlerësua mundësia për të minimizuar ose eliminuar blerjen e tokës. Zgjerimi i rrethrotullimit është projektuar për të qenë më pranë rrethrotullimit ekzistues. Gjatë zbatimit të projektit, do të ketë nevojë për një blerje të vogël të tokës. Janë identifikuar 15 pronarë tokë, të cilët do të preken nga projekti. Është parashikuar se rreth 7.09% e tokës do të shpronësohet për zbatimin e këtij projekti. Saktësisht, 15 parcelat e ndikuara kanë një total prej 22724.5 m². Nga kjo sipërfaqe vetëm 1612 m² do të shpronësohen për nevojat e këtij projekti. (shih tabelën 1)

Harta e gjurmës është e bashkangjitur si Shtojca 1 e këtij dokumenti. Fotot e marra në tokë (pronat) që i nënshtrohen shpronësimit janë bashkëngjitur si Shtojca 2 e këtij dokumenti.

Studimi i regjistrimit të personave të prekur, të drejtat dhe vlerësimi i pasurive

Ky seksion elaboron ndikimet për familje për këtë fazë të projektit. Toka konkrete për shpronësim sa i përket rrethrotullimit ndikon 15 familje të cilat janë të paraqitura në vijim.

Lista e familjeve të prekura dhe përdorimi i tokës

Të gjithë PNP e përfshirë në këtë RAP të shkurtuar zotërojnë tokë tjetër bujqësore në të njëjtën zonë administrative. Pronësia e përgjithshme është paraqitur në tabelën më poshtë. Bujqësia nuk është burimi kryesor / i vetëm i të ardhurave. Megjithëse nuk ka të dhëna zyrtare, vizitat në terren dhe takimet kanë treguar se familjet e prekura marrin të ardhura, kanë bizneset e tyre dhe anëtarët e familjeve janë të punësuar në sektorin privat dhe publik. Të gjitha parcelat e prekura janë toka e papunuara. Dy nga tokat klasifikohen si toka truall por nuk janë përdorur ende për këtë qëllim.

Bazuar në të dhënat e mbledhura në terren, mund të konkludohet se shpronësimi i tokës nuk ndikon në burimin e të ardhurave të PNP. Ky projekt, ndikimet e të cilit janë të paraqitura me këtë RAP të shkurtuar, nuk ka ndikime në jetesën e familjeve të personave të prekur. Nuk ka nevojë për restaurimin e mjeteve të jetesës për shkak të ndikimeve të kësaj faze të projektit. Përdorimi i tokës së prekur është paraqitur në tabelën më poshtë.

Zbatimi i këtij RAP-i të shkurtuar nuk kërkon ndihmë rehabilituese, por vetëm kompensim në të holla për parcelat e tokës bujqësore të shpronësuar.

Tabela e mëposhtme - Tabela 1, paraqet ndikimin në PNP veçmas:

Tabela 1: Të dhëna mbi pronësinë e PNP dhe inventarin e aseteve të tyre

Nr	Bashkia	Emri i pronarit	Nr. pasurie	bashkëpronarë ve	Lloji i tokës	Sipërfaqe totale (m2)	Sipërfaqja e tokës së shpronësuar (m2)	%	Të dhëna reale mbi kultivimin e tokës	Statusi ligjor në ZVRPP
1	Korçe		8/281	3	Truall	1012	192	18.97%	E pakultivuar	Paregjistruar
2	Korçe		9/45	2	Arë	2840	28	0.99%	E pakultivuar	Regjistruar
3	Korçe		9/46	4	Arë	2009	195	9.71%	E pakultivuar	Regjistruar
4	Korçe		9/47	1	Arë	950	91	9.58%	E pakultivuar	Regjistruar
5	Korçe		9/48	1	Arë	1300	121	9.31%	E pakultivuar	Regjistruar
6	Korçe		9/49	1	Arë	1100	106	9.64%	E pakultivuar	Regjistruar
7	Korçe		9/50	4	Arë	1503	178	11.84%	E pakultivuar	Regjistruar
8	Korçe		9/51	1	Arë	1637	120	7.33%	E pakultivuar	Regjistruar
9	Korçe		9/52	1	Arë	994	69	6.94%	E pakultivuar	Regjistruar
10	Korçe		9/53	1	Arë	3049	125	4.10%	E pakultivuar	Regjistruar
11	Korçe		9/54	1	Arë	566	16	2.83%	E pakultivuar	Regjistruar
12	Korçe		9/55	1	Arë	1000	20	2.00%	E pakultivuar	Regjistruar
13	Korçe		8/32	1	Truall	2840	268	9.44%	E pakultivuar	Regjistruar

14	Korçe		8/64	3	Truall	618.5	40	6.46%	E pakultivuar	Regjistruar
15	Korçe		8/288	1	Truall	1310	43	3.28%	E pakultivuar	Regjistruar

Titujt:

Mungesa e titullit / lejeve:

Ekziston një person i ndikuar nga projekti me mungesë të titullit. Ky PNP është në procesin e regjistrimit të pronës dhe totali i tokës është 1012 metra katror. Mungesa e pronësisë zyrtare nuk e privon personin e prekur nga kompensimi. Ndihma dhe udhëzimi i duhur do të jepet për të përfunduar procesin e regjistrimit dhe të kompensohet sipas Marrëveshjes së Huasë.

PNP të tjerë kanë regjistruar prona në Zyrën e ZRPP-së. Ka një shënim mbi certifikatat që i referohen një padie që nga 2001 duke pretenduar pasurinë e 12 tokave. Pronarët aktualë kanë paraqitur një vendim të Gjykatës (Nr. 2184 datë 27.12.2001) që e ktheu padinë pa veprime.

Humbja e të ardhurave:

Nuk ka persona të ndikuar që vuajnë nga humbja e të ardhurave nga shpronësimi. Tokat bujqësore nuk janë kultivuar nga asnjë prej pronarëve. Është konfirmuar nga Bashkia se pjesa tjetër e tokës nga i njëjti pronar ende do të ketë funksionin e saj pasi projekti të zbatohet dhe do të lidhet nëpërmjet rrugëve dytësore. (shih aneksin 5)

Humbja e strukturave:

Nuk do të ketë ndikim në asnjë strukturë.

Humbja e Pronave të Shtetit:

Në të humbjeve të pronës të shtetit, bazuar në legjislacionin Shqiptar, nuk do të shpronësohen. Do të transferohet pa pagesë në pronësi të Shërbimit Publik me një vendim të Këshillit të ministrave. Nuk kemi përdorim të tokës shtetërore nga persona privat. Situata ligjore duke përfshirë ligjin Nr. 10119, dt. 23.04.2009 “Për Planifikimin e territorit”.

Seksioni i mëposhtëm prezanton të drejtat në një format tabelor. (shiko tabelën nr 3).

No	Bashkia	Emri i pronarit	Nr. I pasurisë	Sipërfaqja (m ²)	Sipërfaqja për kompensim (m ²)	Çmimi (ALL) ¹	Kompensimi total (ALL)
1	Korçe		6/1	1012	192	8,537	██████
2	Korçe		2/2	2840	28	8,537	██████
3	Korçe		20/1	2009	195	8,537	██████
4	Korçe		7/5	950	91	8,537	██████
5	Korçe		7/2	1300	121	8,537	██████
6	Korçe		1614/1	1100	106	8,537	██████
7	Korçe		309	1503	178	8,537	██████
8	Korçe		370/15	1637	120	8,537	██████
9	Korçe		349/2	994	69	8,537	██████
10	Korçe		279/3	3049	125	8,537	██████
11	Korçe		36/100	566	16	8,537	██████
12	Korçe		33/24	1000	20	8,537	██████
13	Korçe		64/14	2840	268	8,537	██████
14	Korçe		8/64	614.5	40	8,537	██████

¹ VKM nr. 89 date 03.02.

15	Korçe		8/288	1310	43	8,537	
	Total			22724.5	1612		

Table 2: Tabelë e të dhënave të kompensimit

Kriteret ligjore për vlerësimin e pronësisë

VKM Nr. 138, datë. 23.03.2000, parashikon kriteret ligjore për vlerësimin e pronave të prekura nga shpronësimi.

- **Toka:** Vlerësimi I tokës së shpronësuar do të përcaktohet për tokat urbane, tokat brënda vijës së verdhë të qytetit dhe pronat në njësitë vendore sipas çmimeve të miratuara me VKM që rrjedhin nga ligji me Nr. 9235, datë. 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Private”
- **Pronat Rezidenciale:** Vlera e kompensimit të shpronësimit për *pronat rezidenciale (banesat)* konsiderohet çmimi mesatar I shitjes, sipas të dhënave të Zyrës së regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ZRPP.
- **Pronat Industriale dhe Bujqësore:** Vlera e kompensimit të shpronësimit për pronat industriale dhe bujqësore konsiderohet çmimi mesatar I shitjes, sipas të dhënave të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, ose Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Amortizimi I pasurisë duhet të zbritet nga çmimi.
- **Toka Bujqësore, zona pyjore, etj.:** Vlera e vlerësimit të tokave bujqësore, zonave pyjore dhe kullotave është përcaktuar nga çmimet e miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me ligjin Nr.9235, datë.29.07.2004 “për kthimin dhe kompensimin e tokave private”. Në raste kur nuk ka çmime të miratuara për rajone të caktuara, vlerësimi për tokat bujqësore, zonat pyjore dhe kullotat përcaktohet nga çmimi mesatar I shitjes I vënë në dispozicion nga ZRPP.
- **Pemët Frutore:** Për pemët frutore, vlera e parashikuar është e llogaritur duke marrë parasysh kostot e investimeve dhe shpenzimet. Kjo vlerë është përllogaritur për njësi (nr I pemëve frutore) ose njësi për sipërfaqen e tokës (m² vreshtat etj). Investimi I pranishëm në tokë, shpenzimet totale dhe faktorë të ndryshëm të amortizimit janë parashikuar nga Ministria e Bujqësisë, zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.
- **Të korrat:** për të korrat, vlera është përllogaritur në bazë të rendimentit që pritet dhe të çmimit të tregut për njësi.

Tabela 3: Matrica e të drejtave

Kategoria e PNP	Lloji i humbjes	Të drejtat				
		Kompensimi për humbjen e strukturave	Kompensimi për humbjen e asetëve	Kompensimi për humbjen e të ardhurave	Application Guidelines	Asistencë tjetër
Pronar me certifikatë pronësie	Humbja e tokës Tokë Bujqësore / Toka truall: Prekur nga projekti një pjesë e tokës totale. PNP nuk është zhvendosur.	Kompensimi në Cash me vlerën e zëvendësimit. Të gjitha tarifat dhe kostot e transferimit të pronës të mbuluara nga projekti.	Nuk ka humbje asetesh	Nuk ka humbje të ardhurash	Pagesa e kompensimit të mjeteve monetare për mjetet e humbura kur toka e marrë për projektin është më pak se 20% (WB OP 4.12)	N/A
Pronar të njohur pa certifikatë pronësie	Humbja e tokës Tokë Bujqësore / Toka truall: Prekur nga projekti një pjesë e tokës totale. PNP nuk është zhvendosur.	Kompensimi në Cash me vlerën e zëvendësimit. Të gjitha tarifat dhe kostot e transferimit të pronës të mbuluara nga projekti.	Nuk ka humbje asetesh	Nuk ka humbje të ardhurash	Pagesa e kompensimit të mjeteve monetare për mjetet e humbura kur toka e marrë për projektin është më pak se 20%	Asistencë në regjistrimin e pasurisë

Kriteret e Bankës Botërore për vlerësimin e pronësisë

Në këtë rast kompensimi financiar do të ndjekë Politikat Operacionale për rivendosje të Pavullnetshme (OP 4.12):

“Lidhur me tokën dhe strukturat, ‘kostoja e zëvendësimit’ përkufizohet si vijon: për tokën bujqësore, është vlera e tregut të tokës me kapacitet të njëjtë prodhimi ose përdorimi i vendosur në afërsi të tokës së prekur, përpara zbatimit të projektit ose përpara zhvendosjes (më e larta mes tyre), plus kostot e përgatitjes së tokës për ta sjellë në kushtet e tokës së prekur, plus kostot e çdo rregjistrimi apo taksës. Për shtëpitë dhe struktura të tjera, është vlera e tregut të materialeve që kërkohen për të ndërtuar strukturën e prekur ose për të rregulluar strukturat e prekura pjesërisht, plus kostot e transportit të materialeve në vëndin e ndërtimit, plus kostot e punës dhe të çdo taksë apo regjistrimi. Në përcaktimin e kostove të zëvendësimit, zhvlerësimi i aktiveve të materialeve nuk meret parasysh si dhe as vlera e përfitimit nga projekti nuk i zbritet vlerës së aktivitetit “

Në Politikat Operacionale të Bankës Botërore gjithashtu është e përcaktuar se nëse legjislacioni vendas nuk arrin standartin e kompensimit të përcaktuar nga Banka Botërore, domethënë në kosto të plota të zëvendësimit, kompensimi sipas legjislacionit vendas duhet të plotësohet me masa shtesë në mënyrë që të arrij standartin e përcaktuar.

Kompensimi i propozuar

Kompensimi i Tokës

Në përcaktimin e kompensimit për njësi për tokën në këtë fazë të projektit, Projekti iu referua VKM dhe Hartës së çmimeve të QSH (shih figurën 3) për rajonin e Korçës.

Për të përcaktuar këtë çmim, Projekti ka vlerësuar të dhënat në dispozicion për transaksionet e shitjes së tokës bujqësore, aktet ligjore në fuqi të lëshuara nga Qeveria Shqiptare për shpronësimet për interes publik, çmimi për njësi të shpronësimit për interes publik të kryer në zonën përkatëse ose pranë zonave për t'u shpronësuar, si dhe informacione joformale për shitjet aktuale të tokës.

PNP-të kanë rënë dakord për kompensimin në para cash bazuar në VKM, për çmimin prej 8537 lekë / m², që është çmimi referues për tokën truall në Korçë. Edhe pse 11 nga 15 vendet e prekura janë regjistruar si tokë bujqësore, ato nuk përdoren si të tilla. Bazuar në Zonën Kadastrale ku këto toka janë pjesë, konsiderohet të përdoret si tokë truall. Gjithashtu pronarët kanë paguar tatimin mbi tokën si tokë truall dhe jo bujqësore. Çmimi i kompensimit propozohet të jetë i njëjtë për të gjithë 15 PNP, 8537 lekë / m² plus kostot e transaksionit.

Në këtë rast, PNP-të nuk do të blejnë tokë pasi mjetet e tyre të jetesës nuk janë të bazuara në tokë dhe humbja është vetëm pjesë e të gjithë tokës.

Konsultimet me PNP

Projekti kishte konsultime individuale me PNP-ve, duke pasur parasysh numrin e vogël të PNP-ve. Bazuar në të dhënat e marra nga konsulentit, janë identifikuar PNP individualisht. Procesi i identifikimit dhe konsultimi i PNP-ve u zhvilluan më 17 maj 2019, në Bashkinë e Korçës. Kryetari i komisionit për shpronësim në Bashkinë e Korçës, znj. Arjola Çela pas shpjegimit të situatës aktuale dhe gjendjes ligjore të pronarëve të tokës, të organizuar nga kërkesa e konsulentit, një takim me njerëzit e prekur. U bënë konsultime me pronarët e prekur të tokës dhe po ashtu u plotësua një pyetësor i anketës.

Marrëveshjet me PNP-të janë si më poshtë:

Një PNP që është prekur me 192 metra katror nuk ka pronësi formale. Projekti siguron ndihmë për PNP për të marrë certifikatën e pronësisë. Toka bujqësore nuk është në përdorim. PNP pretendon kompensim si një tokë truall bazuar në Zonën Kadastrale dhe taksën e tokës të paguar si tokë banimi.

14 PNP që janë të prekur me 1420 metra katrorë në total, kanë pronësi formale dhe kanë rënë dakord për pagesën e parave cash si formë e kompensimit. Toka bujqësore nuk është në përdorim. PNP pretendojnë kompensim si një tokë truall bazuar në Zonën Kadastrale dhe taksën e tokës të paguar si tokë banimi.

Përgjegjësitë Institucionale për zbatimin dhe mekanizmi i ankesave

Përgjegjësitë Institucionale për zbatimin e Projektit

ARRSH ka përgjegjësinë përfundimtare për zbatimin e të gjithë komponentëve të projektit.

Një komision i përbërë nga Autoritetet e Projektit dhe PNP do të konstituohet për të qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të PNP.

Bashkia e Korçës është përfituesi përfundimtar i zbatimit të projektit. Për institucionin, kërkohet ndihmë dhe prani e vazhdueshme gjatë gjithë progresit të projektit.

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP). Për institucionin, kërkohet ndihmë dhe prani e vazhdueshme gjatë gjithë progresit të projektit.

Bashkia do të jetë përgjegjëse për koordinimin e procedurave të zbatimit dhe ekzekutimin e kompensimi.

Mekanizmi i ankesave

Ankesat janë një dukuri e zakonshme në rastet e rivendosjes/shpronësimeve të pavullnetshme në të cilat, nëse nuk zgjidhen me mirëkuptim dhe në kohën e duhur, shkaktojnë rritje të rezistencës lokale, tensione politike dhe vonesa të panevojshme në ekzekutimin e këtij projekti. Për shqyrtimin e ankesave për këtë projekt duhet të krijohet një mekanizëm që të adresojë shqetësimet e mundshme legjitime të PNP-ve, të cilët mund ta konsiderojnë veten të privuar nga trajtimi i duhur gjatë këtij projekti.

Informacioni lidhur me ankesat për këtë Projekt do të jetë i shfaqur në faqen e Projektit dhe në Tabelat informuese të projektit. Anëtarët e komunitetit do të kenë mundësinë për të kontaktuar personin e emëruar të shërbimit të Bashkisë Korçë, i cili do të njoftojë NjZP. Ka takime të rregullta që zhvillohen midis Bashkisë Korçë, NjZP (inxhinierët dhe specialisti social), kontraktori dhe supervizioni, përmes së cilës do të bëhet shqyrtimi i ankesave. Në rast se ankesa nuk është e lidhur me marrjen e tokës nga projekti atëherë inxhinierët e projektit, përgjegjësi profesional nga kontraktori, supervizioni dhe përfaqësuesi i Bashkisë Korçë do të takojnë personin që ka bërë ankesën për të adresuar problemin, nëqoftëse ankesa është e lidhur me marrjen e tokës atëherë grupi ishpronësimit të shërbimit të Bashkisë Korçë si dhe specialist social pranë NjZP do të takojnë personin e ndikuar për adresimin e ankesës. Në të dyja rastet personi që ka paraqitur ankesën do të kontaktohet jo më larg se 2 javë nga data e takimit për të diskutuar dhe zgjidhur problemin. Personi i emëruar nga Bashkia Korçë do të monitorojë dhe mbajë regjistrin e ankesave.

Mekanizmi i krijuar nga NjZP ka përfaqësues nga implementimi i këtij projekti, përfaqësues nga përfituesit e projektit dhe një person prej komunitetit. Mekanizmi përshin këto çështje kryesore:

- Sistem regjistrimi dhe raportimi, duke përfshirë si ankesat verbale dhe ato të shkruara;
- Persona përgjegjës të NjZP dhe të përfituesit e projektit Bashkisë Korçë;
- Një afat kohor për adresimin e ankesave.

Funksioni i Mekanizmit të zgjidhjeve të ankesave është monitoruar dhe vlerësuar nga NjZP përgjatë implementimit të projektit dhe gjithashtu do të jetë subjekt i kontrollit të monitorimit të jashtëm final. **Anëtarët e komitetit për tu emëruar në vijim.**

Parimisht, mekanizmi i ankesave është një qasje e lehtë, mekanizëm pa kosto, që përfshin njerzit nga komuniteti, projekti dhe autoritet përkatëse për të menaxhuar dhe zgjidhur problemet para se ato të kalojnë nëpërmjet kanaleve zyrtare, të cilat duan kohë dhe kanë kosto.

Ligji “Mbi Shpronësimin” parashikon një proces ankimimi kundër vendimit të propozuar për kompensim. Për më tepër, ligjet për planifikimin Urban dhe politikat e ndërtimit mundësojnë edhe ankesat administrative të palës që shpronësohet. Ankesat e mëtejshme mund të bëhen në gjykatën e qarkut. Gjithashtu, Zyra e Avokatit të Popullit në Tiranë pranon të shqyrtojë ankesat prej qytetarëve kundër veprimeve të qeverisë që prekin të drejtat e tyre. Stafi I projektit do të

kontribuojë gjithashtu në ndërgjegjësimin e PNP-ve dhe të komunitetit përreth për të drejtat e tyre, si dhe në zgjidhjen e ankesave specifike.

Tabele - 4 Afati kohor dhe buxheti


Steps	Javë														
	W 1	W 2	W 3	W 4	W 5	W 6	W 7	W 8	W 9	W 10	W 11	W 12	W 13	W 14	W 15
Aktivitet e RAP															
- Vizita në Terren															
- CENSUS															
- Konsultime															
Të gjithë PNP-të të informuara															
Hapat e fundit për mbylljen e RAP															
Publikimi i RAP															
Përgatitja e letrës njoftuese nga NjZP Njësive të Qeverisjes Vendore dhe PNP-ve për shpronësim.															
Procedurat për shpronësim të nisura															
Shpronësimi I PNP-ve dhe pagesa.															
Masat e adresimit të ankesave.															
Fillimi I Punimeve.															

Përgatitja dhe asistenca për implementimin e këtij RAP të shkurtuar do të jetë në kujdesin me kohë të plotë nga Specialisti Social i punësuar pranë NjZP. Kështu që, përgatitja dhe mbështetja në implementimin do të financohet nga kostot operationale të këtij projekti.

Kompensimi i PNP-ve do të financohet nga Qeveria e Shqipërisë. Vlera totale e kompensimit për këtë fazë të projektit është përlogaritur në shumën e [REDACTED] ALL plus kosto të transaksioneve, e vlefshme për shpronësimin e një sipërfaqeje totale prej 1612 m² (për pronat private), të ndikuara nga shpronësimi i këtij RAP të këtij projekti.

Aneks-1

Rrethrotullimi Korçë – Gjurma e projektit



Aneks -2

Rrethrotullimi Korçë – Foto nga vizita në terren









Aneks - 3


Çmimi i pasurisë sipas VKM nr. 89 datë 03.02.2016

Fletorja Zyrtare



Viti 2016 – Numri 14

**VLERA E PASURISE SE PALUAJTSHME TE LLOJIT TOKE TRUALL
QYTETI KORÇE
2014**



	Nr.	QYTETI, FSHATI	NUMRI I ZONES KADASTRALE	TOKE TRUALL (leke/m ²) 2014
	1	KORÇE 1	8561	8537
	2	KORÇE 2	8562	9055
	3	KORÇE 3	8563	7535
	4	KORÇE 4	8564	8537

Aneks 4

Dokumentimi i konsultimeve me PNP, 17 Maj 2019





Aneks 5

Projekti i infrastrukturës rrugore që lidh parcelat e mbetura të PNP-ve



